

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2024

Nr. Rendor (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti i kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundimit të kërkesës (6)	Tarifa (7)
1	08.01.2024	Sa është në total numri i të punësuarve në kompanitë call center për 2023? Po numri i kompanive?	16.01.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se: Numri i punonjësve është 9837 dhe numri i subjekteve është 443. Këto të dhëna janë për periudhën 11 mujore të vitit 2023.	E plotë	Nuk ka
2	19.01.2024	Sa të ardhura ka pasur buxheti i shtetit nga tarifat që grumbullohen prej institucionit tuaj prej dy kompanive X gjatë vitit 2023?	07.02.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se: Administrata Tatimore për të gjeneruar të dhëna të sakta e bën verifikimin e subjekteve vetëm nëpërmjet NIPT/NUIS (Numri i identifikimit të personit të tatueshëm), e cila është e vetmja e dhënë unike që bën të mundur identifikimin e tatimpaguesit. Sa më lart përmendur, lutemi na vendosni në dispozicion të dhënat identifikuese NIPT/NUIS, me qëllim shkëmbimin e informacionit statistikor që mund të shkëmbehet në zbatim të Ligjit "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar.	E plotë	Nuk ka
3	29.01.2024	Sa persona rezultuan të punësuar në call center në	30.01.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj, iu informojmë se: Për vitin 2015 numri mesatar i punonjësve është 16,194, për	E plotë	Nuk ka

		vitin 2015, 2018, 2022 dhe 2023?		vitin 2018 numri i punonjësve është 19,439, për vitin 2022 numri i punonjësve është 13,096 dhe për vitin 2023 numri i punonjësve është 10,432.		
4	30.01.2024	Kërkesë për informacion mbi informalitetin e pagave.	12.02.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Administrata Tatimore ka filluar Planin e luftës ndaj Informalitetit të Pagave prej Dhjetorit 2021, bazuar në Urdhrin Nr.1, datë 05.01.2022 të Kryeministrit “Për ngritjen e njësisë special anti-informalitet për të ardhurat nga punësimi dhe shërbimet”, grupit të punës dhe sekretariatit teknik. Administrata Tatimore me qëllim analizimin e nivelit të pagave të deklaruara, identifikoi disa kritere risku, ku ndër to përmendim: tatimpaguesit që kanë pagë të deklaruar për kontribute për 80%-100% të punonjësve të tyre deri në nivelin e pagës minimale. Si rezultat i kësaj në Dhjetor 2021 u identifikuan 3.882 tatimpagues, të cilët për 62.905 punonjës të tyre kanë pagë të deklaruar deri në nivelin minimal. Për këto Tatimpagues, u hartuan dhe u dërguan të personalizuar me qëllim deklarimin e pagave reale të punonjësve të tyre. Nisma e radhës e ndërmarrë lidhur me informalitetin në tregun e punës i përket periudhës Dhjetor 2021, ku u identifikuan 10.153 tatimpagues të cilët deklarojnë për 95.214 punonjës të tyre nivelin min. të pagës. Për	E plotë	Nuk ka

				10.153 tatimpaguesit me risk u nisën letra të personalizuar nëpërmjet postës ashtu dhe në llogarinë elektronike në sistemin C@TS, ku i kërkohej deklarimi i pages reale për punëmarrësit e tyre.		
5	14.02.2024	Kopje e kontratave të marrjes me qira të pronave të paluajtshme nga ana e DPT.	26.02.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Mbështetur në ligjin 9920 ‘Për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar dhe në ligjin 9887 ‘Për mbrojtjen e të dhënave personale, i ndryshuar, Administrata Tatimore është e detyruar të ruajë të dhënat tregtare dhe personale të subjektit.	Refuzuar	Nuk ka
6	21.02.2024	Kërkesë për informacion për projektin pilot për “Hetimi i pasurisë së pajustificuar”.	05.03.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë se: Ky është një projekt pilot i ndërmarrë nga Administrata Tatimore në bashkëpunim me DPSHTRR i parashikuar për implementim në vitin 2026, siç përcaktohet në Vendimin Nr. 12, datë 11.01.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2024–2026”, ku janë paraqitur disa nga politikat makro-fiskale që Administrata Tatimore do të ndërmarrë me qëllim vendosjen e një ekuilibri optimal midis mundësive dhe rrisqeve në luftën kundër informalitetit. Nuk është faza e parë, pasi këtë metodologji e kemi përdorur edhe gjatë zbatimit të planit të punës për Informalitetin në tregun e punës, i cili rezultoi i suksesshëm. Tani thjeshtë po zgjerojmë iniciativën. Aktualisht jemi	E plotë	Nuk ka

				<p>në fazë idesh, diskutimesh për identifikimin e hapave që do të bëjë secila palë, ku ky projekt pilot do të implementohet. Procesi mendohet të fillojë gjatë vitit 2025 me mbylljen e deklaramit të të ardhurave vjetore për vitin 2024. Numri është në varësi të individëve që do të konsiderohen me risk të mospërbushjes. Nëse rezultojnë mosdeklarime të ardhurash të vërtetuara do të zbatohen dispozitat ligjore të ligjit 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar dhe ligjit ‘Të Tatimit mbi të Ardhurat’, ku përfshihen edhe penalitetet për mosdeklarim. Objektivi drejt pagave reale është një na misionet që ka Administrata Tatimore dhe po përdoren disa forma trajtimi duke filluar nga ndërgjegjësimi I punonjësve, punëdhënësve tatimpagues, deri tek kontrollet verifikuese tek tatimpaguesit e konsideruar me risk të lartë, (paga të ulëta në kufinj të pagës minimale, pagë dukshëm jashtë realitetit të profesioneve të caktuara).</p>		
7	25.04.2024	Informacion mbi heqjen e taksës së ndërtimit për banesat e dëmtuara nga tërmeti.	07.05.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj ju informojmë se: Nga verifikimet e bëra, rezulton se, për kontratë bashkëpunimi me familjen X, shoqëria “X” sh.p.k, nuk ka bërë asnjë kërkesë për t’u pajisur me autorizim për përjashtim nga TVSH-ja në kuadër të programit të rindërtimit sipas	E plotë	Nuk ka

				VKM Nr. 143 datë 13.02.2020 "Për procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit" i ndryshuar. Për një informacion më të detajuar, lutemi të na dërgoni: Emrin dhe NIPT-in e tatimpaguesit që ka bërë kërkesën për t'u pajisur me autorizim për përjashtim nga TVSH-ja; Datën dhe numrin e protokollit të kërkesës së mësipërme.		
8	09.05.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion dokumentet zyrtar/informacion në lidhje detyrimet financiare që kompania ajrore "x" ka ndaj shtetit shqiptar.	21.05.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Në nenin 24 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, janë përcaktuar shprehimisht autoritetet të cilave Administrata Tatimore ka detyrimin e vënies në dispozicion të informacionit tatimor lidhur me tatimpaguesin, si dhe rastet e dhënies së këtij informacioni. Ndërsa në nenin 25 "Konfidencialiteti", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, parashikohet se: "Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore, dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës."	Refuzuar	Nuk ka

				Administrata Tatimore konstaton se të dhënat e kërkuara nga ana juaj përbëjnë të dhëna tatimore bazuar në nenin 31, "E drejta për konfidencialitetin e të dhënave", pika 2 e ligjit të sipërcituar, ku përcaktohet se: "E dhënë tatimore dhe financiare është çdo informacion, i cili merret nga administrata tatimore, gjatë ushtrimit të funksioneve, tek tatimpaguesi ose palët e treta".Referuar sa më sipër, Administrata Tatimore ka detyrimin ligjor të ruajtjes së konfidencialitetit të tyre.		
9	13.05.2024	Informacion mbi profesionet e lira, kush janë kategoritë e tyre, kriteret që duhet të përmbushë një person fizik që të taksohet si "profesionist i lirë". Sipas përlllogaritjeve paraprake të bëra nga institucionet shtetërore, sa janë të ardhurat vjetore që shkojnë në buxhetin e shtetit nga tatimi i profesioneve të lira.	07.06.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Sa i përket pyetjes se cilat janë kategoritë e profesioneve të lira në Shqipëri të cilat janë parashikuar të taksohen si të tillë, sqarojmë se kategoritë janë përcaktuar në VKM nr. 753, datë 20.12.2023, për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat". Në lidhje me pyetjen nr. 2, taten si profesionist i lirë personat fizikë të vetëpunësuar dhe entitete që ofrojnë shërbime profesionale sipas listës analitike që përbëhet nga veprimtaritë sipas kodeve të parashikuara në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (rev. 2), të paraqitura në tabelën analitike nr. 2. Sa i takon pyetjes nr. 3, Administrata Tatimore sqaron se përlllogaritja e tatimit për kategorinë e subjekteve me aktivitet "shërbime	E plotë	Nuk ka

				<p>profesionale" kryhet në zbatim të: Ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Vendimit Nr. 753, datë 20.12.2023, Aktin Normativ Nr. 7, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 29/2023 'Për tatimin mbi të ardhurat', të ndryshuar. Për Personat fizik të cilët ushtrojnë aktivitetet "Shërbime Profesionale", llogaritja e parapagimeve kryhet me normat progresive: 15% deri në 14 milion dhe 23% për çdo vlerë të fitimit mbi 14 milion lekë. Për periudhën prill-dhjetor 2024, parapagimet bazohen mbi fitimin e deklaruar në deklaratën tatimore vjetore 23-A, pavarësisht regjistrimit të tyre apo deklaratës së dorëzuar për TF apo TFTH. Për tatimpaguesit të cilët kanë status të ndryshëm ligjor nga person fizik aktiviteti kryesor i të cilëve është shërbime profesionale, pavarësisht përgjegjësisë së tyre tatimore, llogaritja e parapagimeve kryhet me normën 15% mbi fitimin. Për periudhën prill-dhjetor 2024, parapagimet bazohen mbi fitimin e deklaruar në deklaratën tatimore vjetore 23-A, pavarësisht regjistrimit të tyre apo deklaratës së dorëzuar për TF apo TFTH.</p>		
10	09.07.2024	Informacion mbi bazën ligjore apo nënligjore, që ka përcaktuar në vitin 2022, se të gjithë faturat tatimore me	25.07.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, lutem gjeni bashkëlidhur dispozitën ligjore Udhëzimi nr. 16, datë 03.04.2020 "PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË	E Plotë	Nuk ka

		statusin dorëzuar do të kalojnë automatikisht në statusin pranuar nëse mbi to nuk është ndërmarrë asnjë veprim.		QARKULLIMIT" i ndryshuar me Udhëzim Nr. 5, datë 23.2.2021 "PËR DISA SHITESA DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 3.4.2020", "PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT" neni 20, pika 13, ku përcaktohet se: "13. Të dhënat nga librat e blerjeve dhe shitjeve të evidentuara deri në ditën e dhjetë të muajit pasardhës, nëse nuk janë deklaruar nga ana e tatimpaguesit, do të deklarohen automatikisht. Këto të dhëna do të përdoren për të plotësuar dhe kontabilizuar deklaratën e TVSH-së së muajit respektiv, pavarësisht nëse tatimpaguesi ka konfirmuar ose jo këto të dhëna. (Rifomuluar me Udhëzimin Nr. 5, datë 23.02.2021, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 30, datë 26.02.2021)".		
11	18.07.2024	Informacion mbi numrin e punonjësve me paga të nëndeclaruara, sektorët me shkeljet më të mëdha?	31.07.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Nuk disponojmë shifra për numrin e punonjësve me paga të nëndeclaruar por në të gjitha nismat e ndërmarrë ndiqet praktika me bazë risku për të identifikuar këto raste, p.sh identifikimi i punonjësve me pagë të deklaruar nën pagën mesatare të profesionit duke marrë në konsideratë sektorin ku operon biznesi, ditët e punës të punuara në subjekt, kategorinë e	E plotë	Nuk ka

				<p>kotributeve etj. Nga 2020 e në vazhdim Administrata Tatimore ka marrë disa nisma të tematikave kryesore informalitetin në tregun e punës në të 4 komponentet e tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mosdeklarimin e punonjësve</li> <li>• Nëndeklarimin e pagave</li> <li>• Mosdeklarimin e saktë të kohës së punës</li> <li>• Mosdeklarimin e saktë të kategorisë së punësimit dhe profesionit</li> </ul>		
12	09.08.2024	<p>Sa ka qenë numri i punonjësve me datën 1 janar 2019, 1 janar 2020, 1 janar 2021, 1 janar 2022, 1 janar 2023, 1 janar 2024 I kompanisë X?</p> <p>2- Sa ka qenë numri i punonjësve me datën 1 janar 2019, 1 janar 2020, 1 janar 2021, 1 janar 2022, 1 janar 2023, 1 janar 2024 I kompanisë X?</p>	19.08.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se numri i të punësuarëve për subjektin X është:</p> <p>2019 janar-6 2020 janar-7 2021 janar-6 2022 janar-6 2023 janar-5 2024 janar-8</p> <p>numri i të punësuarëve për subjektin X është:</p> <p>2019 janar-39 2020 janar-41 2021 janar-45 2022 janar-37 2023 janar-42 2024 janar-38</p>	E plotë	Nuk ka

13	14.08.2024	Informacion lidhur me shkresën e dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë.	21.08.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se ju vazhdoni të jeni e punësuar dhe deklaruar pranë subjektit X. Nga verifikimi në sistemin tatimor rezulton se në listëpagesat e këtij tatimpaguesi ju jeni deklaruar si "i punësuar, i cili për gjithë muajin ka qenë me raport barrëlindje dhe përfiton nga skema e sigurimeve shoqërore" për më shumë se 12 periudha, kur leja e barrëlindjes nuk mund të jetë më shumë se 1 vit kalendarik.</p> <p>Shkresa i drejtohet subjektit tatimpagues, për të dhënë informacion dhe dokumentacion justifikues për situatën si më lart.</p>	E plotë	Nuk ka
14	16.08.2024	Sa është numri i gjobave të vendosura nga institucioni juaj, në periudhat: Janar-maj 2023 Janar-maj 2024	20.08.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se:</p> <p>Numri i shkeljeve për periudhën janar-maj 2023 është 76</p> <p>Numri i shkeljeve për periudhën janar-maj 2024 është 453</p>	E plotë	Nuk ka
15	25.09.2024	Sa është numri i këngëtarëve që kanë paguar tatim vjet dhe këtë vit? Sa është vlera e tatimit që ata kanë paguar për këto dy vite 2023 dhe pjesa e parë e 2024?	11.10.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev 2 nuk ka një përcaktim të tillë, tatimpagues të regjistruar si këngëtarë. Sqarojmë se AT administron të dhëna lidhur me këta tatimpagues vetëm sipas llojit të veprimtarive të parashikuara nga Nomenklatura e Kodeve Ekonomike NVE</p>	E plotë	Nuk ka

				Rev 2 dhe jo sipas përcaktimit të cituar nga kërkuesi. Lutem bashkëlidhur gjeni Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev 2, përmes së cilës mund të përcaktohet lloji i aktivitetit dhe kodi NVE Rev 2 për të cilën jeni interesuar.		
16	30.09.2024	Numri i individëve subjekt i tatimit mbi dividendin për vitin 2023. Numri i subjekteve ekonomike/subjekteve që kanë shpërndarë dividend për vitin 2023.	15.10.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Numri i individëve subjekt i tatimit mbi dividendin për vitin 2023 në total është 2006. Numri i subjekteve ekonomike/bizneseve që kanë shpërndarë dividend për vitin 2023 është në total 2870.	E plotë	Nuk ka
17	02.10.2024	Informacion lidhur me kontrollet periodike të DPT, si agjent fiskal i ISSH, për pagimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të të punësuarëve në kompanitë mediatike.	16.10.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si vijon: Administrata Tatimore ka filluar Planin e luftës ndaj Informalitetit të Pagave prej Dhjetorit 2021, bazuar në Urdhrin Nr.1, datë 05.01.2022 të Kryeministrit “Për ngritjen e njësisë speciale anti-informalitet për të ardhurat nga punësimi dhe shërbimet”, grupit të punës dhe sekretariatit teknik. Në vijim të masave të marra nga Administrata Tatimore për të luftuar këtë fenomen, në shtator 2021 nisi analizimi i nivelit të pagave të deklaruara, ku u identifikun disa kritere risku. Ndër to përmendim: tatimpaguesit që kanë pagë të deklaruar për kontribute për 80%-100% të	E plotë	Nuk ka

			<p>punonjësve të tyre deri në nivelin e pagës minimale.</p> <p>Si rezultat i kësaj në Dhjetor 2021 u identifikuan 3.882 tatimpagues, të cilët për 62.905 punonjës të tyre kanë pagë të deklaruar deri në nivelin minimal. Për këto Tatimpagues, u hartuan dhe u dërguan letra të personalizuar me qëllim deklarimin e pagave reale të punonjësve të tyre.</p> <p>Nisma e radhës lidhur me informalitetin në tregun e punës i përket periudhës dhjetor 2021, ku u identifikuan 10.153 tatimpagues të cilët deklarojnë për 95.214 punonjës të tyre nivelin minimal të pagës. Për 10.153 tatimpaguesit me risk u nisën letra të personalizuar nëpërmjet postës ashtu dhe në llogarinë elektronike në sistemin C@TS, ku i kërkohej deklarimi i pagës reale për punëmarrësit e tyre.</p> <p>U realizuan gjithshtu 4.824 telefonata nga Qendra e Thirrjeve, nga të cilat janë përgjigjur 2.528 tatimpagues.</p> <p>Në bazë të kriterëve të riskut të përcaktuara nga njësia janë përzgjedhur për kontroll 18 tatimpagues që i përkasin kryesisht aktiviteteve ndërtim, tregti, arsim privat, media dhe shoqëri sigurimesh.</p> <p>Referuar analizës së fundit të listëpagesës Mars 2022, nga matja e reagimit të tatimpaguesve të cilësuar me risk për të</p>		
--	--	--	---	--	--

				cilët është dërguar letër e personalizuar për deklarin real të pagës, 58% e tyre kanë reaguar me rritje të pagave. Në total kemi një rritje prej + 5% më shumë kontribute shoqërore e shëndetësore.		
18	04.10.2024	Sa janë të ardhurat vjetore mesatare të gazetareve/punonjësve të medias në Shqipëri? Disagregim sipas gjinisë, grupëmoshës dhe qytetit?	11.10.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se: Kjo kategori tatimpaguesish gazetare/punonjës të medias regjistrohet në QKB dhe kodi NACE-2 bëhet me vetëdeklarim nga ana e tyre. Të dhënat e regjistrimit, konkretisht Klasa 4 shifrore, transmetohen nga QKB dhe AT është përfitues i të dhënave. AT më pas, administron të dhënat e dërguara për tatimpaguesit, me ndarje të llojit të veprimtarive ekonomike sipas klasave të parashikuara në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev 2, dhe jo sipas përcaktimeve të bëra nga kërkuuesi.	E plotë	Nuk ka
19	07.10.2024	Sa është numri i subjekteve, në bazë qarku/rrethi për sektorët si: hoteleri, bar, restorante, markete.	10.10.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, lutemi bashkëlidhur gjeni informacionin e kërkuar. Berat-1006, Dibër-489, DTM-89, Durrës-3349, Elbasan-1916, Fier-2206, Gjirokastër-781, Korçë-1567, Kukës-352, Lezhë-1206, Sarandë-1685, Shkodër-1632, Tiranë-8303, Vlorë-2108.	E plotë	Nuk ka
20	07.10.2024	A ka kryer AT ndonjë auditim tatimor të kompanisë x gjatë viteve 2014-2016? A ka hetuar AT ndonjë skemë të manipulimit	18.10.2024	Administrata Tatimore sqaron se për subjektin x ka kryer kontrollë tatimore gjatë viteve 2014-2016. Lidhur me pyetjen tuaj, ju bëjmë me dije se, subjekti x është referuar në Prokurori. Ky rast nuk është ndjekur nga ana e	E plotë	Nuk ka

		financiar ose shmangies së taksave për kompaninë x?		Drejtorisë së Hetimit Tatimor pas referimit, si dhe aktualisht nuk ka çështje në ndjekje nga ana jonë.		
21	10.10.2024	Sa është numri i OJF të regjistruara? Sa është numri i të punësuarëve?	16.10.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: numri i OJF të regjistruara në DPT deri në datë 15.10.2024 në total është 5761. Numri i të punësuarëve në OJF për listëpagesën e muajit gusht 2024 është 9363 në total.	E plotë	Nuk ka
22	15.10.2024	Informacion lidhur me Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave	24.10.2024	<p>Individi X, rezulton se ka qenë e dypunësuar për periudhën nëntor-dhjetor 2024 te tatimpaguesit X. Kjo deklaratë, DIVA 2023, ka patur afat deklarimi pa penalitet dhe pa kamatëvonesa (interes) deri në datë 30.04.2024, por tatimpaguesi e ka gjeneruar në sistem këtë deklaratë në datë 14.10.2024, e cila rezulton ende e pa dorëzuar por që detyrimi është i barabartë me shumën e afishuar më sipër.</p> <p>Referuar LIGJI nr.8438 datë 28.12.1998 'Për tatimin mbi të ardhurat' i ndryshuar, Neni 13 "Përfshihen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2 000 000 (dy milionë) lekë. Ky përjashtim nuk zbatohet për individët, të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës. Këta individë deklarohen në deklaratën e</p>	E plotë	Nuk ka

				tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruara nga punësimi, zbresin tatimin e mbajtur nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën e detyrimit tatimor që duhet të paguajë për buxhetin e shtetit.		
23	21.10.2024	Informacion për të përditësuar adresën në e-filing	22.10.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Tatimpaguesi ka dërguar pamjen e NID të vet që mund të bëjë deklarimin e DIVA ose Tatimit në Burim dhe nuk ka paraqitur një NIPT të regjistruar.</p> <p>Njoftimi në faqen e DPT kërkon që të plotësojnë adresë vetëm personat e regjistruar me një NIPT, bashkangjitur njoftimi nga DPT. Tatimet: Depozitoni të dhënat e pronësisë apo kontratën e qirasë për vendushtrimin e aktivitetit ekonomik në e-Filing</p> <p>“Mosdeklarimi i adresës së ambjentit ku ushtroni aktivitet konsiderohet kundërvajtje administrative me ligj”</p> <p>Administrata Tatimore fton të gjithë tatimpaguesit, që brenda datës 20 Tetor, të deklarojnë ne e-Filing informacionin mbi statusin e pronësinë ose jo, të vendit/vendeve të ushtrimit të aktivitetit të tyre ekonomik, si dhe të dorëzojnë dokumentacionin përkatës që e vërteton ata (dokumentin e pronësisë, kontrate qeraje etj.).</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>Ky informacion shërben për përlllogaritjen e saktë të Tatimit në Burim si dhe krijimin e mundësisë për parambushjen e Deklaratës së të ardhurave personale, për individët subjekt deklarimi.</p> <p>Depozitimi apo përditësimi i këtyre të dhënave, nga llogaria personale ne e-filing, duhet të plotësohet nga çdo tatimpagues, pra nga çdo NIPT, si për adresen kryesore ashtu edhe për ato sekondare.</p>		
24	23.10.2024	Informacion sesi mund të paguajë online pagesën e detyrimeve për Tatimin mbi të Ardhurat, DIVA.	23.10.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se detyrimin DIVA ‘Tatimin mbi të ardhurat’ mund t’u paguani në çdo bankë të nivelit të dytë dhe në çdo zyrë të ‘Postës Shqiptare’. Sa i takon pagesës nëpërmjet platformave online që ofrojnë bankat, ju bëjmë me dije se mund ta kryeni, por duhet të jeni të kujdesshëm në vendosjen e numrit serial të urdhërpagesës, të cilën mund ta shkarkoni nga portal e-filing.</p>	E plotë	Nuk ka
25	25.10.2024	<p>Sa është niveli i informalitetit në ekonominë shqiptare në 2024?</p> <p>Cilët janë sektorët me më shumë informalitet në Shqipëri?</p> <p>Cilat janë rezultatet e Njesisë Speciale Antiinformalitet për të Ardhurat nga Punësimi dhe Shërbimet</p>	04.11.2024	<p>Administrata Tatimore në përmbushje të detyrimeve të saj funksionale mat dhe disponon të dhëna që kanë lidhje me indikatorët e përmbushjes së tatimpaguesve dhe nuk bën analiza apo vlerësime makro mbi ekonominë.</p> <p>Tatimpaguesit me numrin më të lartë të thyerjes së rregullave të riskut në sistemin informatik tatimor i përkasin aktiviteteteve si më poshtë:</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>ngritur në mbështetje të Urdhrit të Kryeministrit në muajin janar 2022?</p>		<p>Aktivitete të shërbimit të pijeve,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara me mbizotërim ushqimor,</li> <li>• pije dhe duhan,</li> <li>• shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara,</li> <li>• tregtia me shumicë jo e specializuar,</li> <li>• restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm,</li> <li>• ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jo rezidenciale,</li> <li>• hotele dhe struktura të ngjashme.</li> </ul> <p>Falë kontrolleve të vazhdueshme të Njësisë Speciale Antiinformalitet për të Ardhurat nga Punësimi dhe Shërbimet ka pasur një ulje të pozicioneve të punës me pagë minimale, si dhe një rritje të ndjeshme të atyre pozicioneve që kanë deklaruar rritje në paga. Ndërkaq, kontributet shoqërore dhe shëndetësore kanë pësuar rritje, më konkretisht:  23% më pak pozicione pune me page minimale,  26% më shumë pozicione pune që kanë deklaruar rritje në paga,</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				Mbi 7% rritje të Kontributeve Shoqërore dhe Shëndetsore.		
26	28.10.2024	Informacion lidhur me DIVA 2023.	29.10.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: referuar të dhënave sipas deklarimeve në listëpagesa rezulton se; individi x për periudhën janar-dhjetor 2023 ka përfituar të ardhura bruto nga paga në vlerën mbi 2 milion lekë.</p> <p>Bazuar në këto të dhëna dhe sipas përcaktimit në pikën 4 të nenit 13 të ligjit 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe UMF nr.5 datë 30.01.2006, i ndryshuar paragrafi 2.8.1.3 ka detyrimin për dorëzimin e DIVA 2023.</p> <p>Përsa i përket kërkesës së tatimpaguesit për informacion se si kryhet pagesa e detyrimit sqarojmë se: për të kryer pagesën tatimpaguesi duhet të printojë në llogarinë e tij në e-filing formularin e urdhër-pagesës i cili gjendet te menuja/Kontabiliteti/Urdhër-pagesa. Me të dhënat referuese të këtij dokumenti mund të kryhet pagesa pranë çdo banke të nivelit të dytë apo në sportelin e Zyrave postare si edhe elektronikisht.</p>	E plotë	Nuk ka
27	28.10.2024	Informacion lidhur me DIVA 2023.	1.11.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Bazuar në Ligjin me Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, Neni 13/6 “tatimi për tu paguar” dhe Udhëzimi Nr.5 datë 30.01.2006 në zbatim të tij, pika 2.3” Të Ardhurat e Tatushme”,</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>individit x rezulton subjekt deklarimi për DIVA 2022, DIVA 2023</p> <p>Kjo bazuar edhe mbështetur në Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat“, i ndryshuar, Përsa i përket individëve që rezultojnë të punësuar në më shumë se një punëdhënës ose që përfitojnë dy ose më shumë paga në një muaj, Neni 13/2“ <i>Tatimpaguesi, në deklaratën vjetore të të ardhurave, jep të dhëna për të ardhurat bruto, në të cilat përfshihen: a) Të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individ</i>“ dhe Udhëzimi Nr.5 datë 30.01.2006 në zbatim të tij, (pika 2.3” Të Ardhurat e Tatushme,2.31 2.3.1. Pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës (të ardhurat nga punësimi).</p> <p>Nëse ka kundërshtime për penalitetin e vendosur, sipas nenit 113 të Ligjit 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,, mund të paraqese kërkesën për tu pajisur me Njoftim Vleresimi për ta ankimuar pranë Drejtorise së Apelit Tatimor.</p>		
28	05.11.2024	Informacion mbi borxhet totale të akumuluar nga subjektet private dhe ato shtetërore për detyrimet e prapambetura për Kontributet Shoqërore.	15.11.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Totali i detyrimeve të papaguara në zërin kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore: 24,244,932 mijë lekë. Në zbatim të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat	E plotë	Nuk ka

		<p>Cilat kanë qenë masat konkrete ndaj këtyre subjekteve?</p> <p>Sa procese gjyqësore janë aktivizuar në 5 vitet e fundit lidhur me këto problematika ndaj SHA-ve publike?</p>		<p>tatimore në RSH" i ndryshuar "Administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor". Nisur nga rëndësia e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, një ndër objektivat kryesore të Administratës Tatimore është ndjekja e me përparësi e detyrimeve në kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Procedurat konkrete të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara janë të detajuara sipas neneve 88-104 të ligjit nr. 9920/2008. Administrata Tatimore nuk fillon procese gjyqësore për detyrime tatimore të maturuara dhe kontabilizuara, por ndjek masat shtrënguese sipas ligjit.</p>		
29	08.11.2024	<p>Informacion sipas fashave të referuara në Tabelën ilustruese Tabela 1 për çdo sektor sipas aktiviteti Ekonomik NVE REV.2 sipas ndarjes të përcaktuar në Tabelën 2, me informacionin më të fundit të përditësuar.</p>	21.11.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, gjeni bashkëlidhur informacionin e kërkuar.</p>	E plotë	Nuk ka

30	12.11.2024	<p>Si ka avancuar procesi i kalimit të shërbimeve tatimore në një platformë të plotë digjitale deri më tani? A ka ndodhur implementimi i plotë i shërbimeve digjitale për tatimpaguesit, dhe nëse jo cilat shërbimet ende nuk ofrohen në mënyrë digjitale? A mund të na jepni informacion mbi mënyrën sesi po identifikohen bizneset që duhet të inspektohen?</p>	25.11.2024	<p>Administrata Tatimore është një nga administratat e cila ofron 98% të shërbimeve online. Konkretisht AT ofron 31 shërbime online të cilat lëshohen elektronikisht nëpërmjet portalit e-albania dhe 13 shërbime ofrohen nëpërmjet e-filing. Prej periudhës së fillimit të aplikimit deri sot këto shërbime janë përmirësuar dhe shtuar në numër. Kjo mënyrë e re e ofrimit të shërbimeve online, i ka krijuar mundësinë tatimpaguesve dhe individëve të marrin shërbimin e kërkuar, duke reduktuar ndjeshëm kontaktet e drejtëpërdrejta me administratën, rradhët e gjata dhe kohën e pritjes.</p> <p>Përzgjedhja e tatimpaguesve bëhet automatikisht nga sistemi pa lënë hapësira për t'u ndryshuar manualisht.</p> <p>Rastet e gjeneruara automatikisht nga moduli i Riskut dërgohen për aprovim në Komitetin e Riskut. Komiteti i Riskut miraton dhe përzgjedh format e trajtimit të subjekteve me Risk.</p> <p>Tatimpaguesit sipas nivelit të riskut të paraqitur trajtohen në forma të ndryshme. Ata me risk të lartë vendoset të dërgohen për kontroll të plotë/vizita fiskale ndërsa tatimpaguesit me risk të mesëm ose të ulët me verifikim në terren, njoftime POP UP ose letra të personalizuar.</p>	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------

31	20.11.2024	Kërkesë për zhbllokimin e llogarive bankare.	25.11.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Për tatimpaguesin x është vepruar me lirim të llogarive bankare sipas shkresës nr.60384 prot., datë 18.11.2024, për të cilën janë njoftuar të gjitha bankat e nivelit të dytë nëpërmjet postës elektronike dhe asaj zyrtare.	E plotë	Nuk ka
32	27.11.2024	Kërkesë për pagesë të detyrimeve tatimore me këste.	10.12.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Në bazë të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe akteve të tjera të cilat rregullojnë funksionimin e marrëveshjeve të pagesës së detyrimit me këste, tatimpaguesi paraqet kërkesë për marrëveshje dhe është Organi Tatimor që vlerëson nëse plotëson kushtet për lidhjen e kësaj marrëveshje. Nga verifikimi i të dhënave në sistemin tatimor, vihet re që individi ka aftësi paguese për të shlyer detyrimin për të cilin ka kërkuar lidhje akt marrëveshje.	E plotë	Nuk ka
33	29.11.2024	Cilat janë masat që merren ndaj kompanive që nuk shlyejnë detyrimet tatimore? Si është procedura që ndiqni për individët që nuk	13.12.2024	Masat shtrënguese ndiqen sipas përcaktimeve ligjore në Ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore të dala në bazë	E plotë	Nuk ka

		<p>paguajnë taksën e dypunësimit?</p>		<p>dhe për zbatim të tij lidhur me mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.</p> <p>Masat Shtrënguese që ndiqen nga Administrata Tatimore në funksion të mbledhjes së detyrimeve tataimore të papaguara janë:</p> <p>Njoftimi dhe kërkesa për pagesë,  Urdhër bllokimi i llogarive bankare,  Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese,  Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore,  Njoftim për vendosjen e barrës siguruese,  Urdhër sekuestrimi,  Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë,  Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98,  Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit,  Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë,  Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB,  Konfiskimi i 50% te xhiros ditore</p> <p>Masat Shtrënguese që ndiqen nga Administrata Tatimore në funksion të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara për tatimpaguesit “Individë” janë:</p> <p>Njoftimi dhe kërkesa për pagesë,  Urdhër bllokimi i llogarive bankare,</p>		
--	--	---------------------------------------	--	---	--	--

				<p>Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese,  Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore,  Njoftim për vendosjen e barrës siguruese,  Urdhër sekuestrimi,  Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë.</p>		
34	04.12.2024	<p>Informacion për hapat që duhen ndjekur (apo dokumentacionet, aplikimet që duhen bërë), për të hapur një call-center.</p>	05.12.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon:  Për regjistrimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) në Republikën e Shqipërisë, duhet të ndiqen disa hapa të caktuar. Më poshtë është një përshkrim i procedurës:  1. Zgjedhja e Emrit të Shoqërisë  Emri i shoqërisë duhet të jetë unik dhe të mos përputhet me emrat e shoqërive ekzistuese. Mund të kontrolloni disponueshmërinë e emrit përmes Regjistrimit të Bizneseve.  2. Përgatitja e Dokumenteve Të Nevojshme  Këto janë dokumentet që duhen përgatitur për regjistrimin e shoqërisë:  Kërkesa për regjistrim (formulari standard që mund të merret nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit).  Kopje e dokumenteve të identifikimit të themeluesve (pasaportë ose kartë identiteti).</p>	E plotë	Nuk ka

			<p>Statuti i shoqërisë, i cili përmban informacionet thelbësore rreth funksionimit të shoqërisë, emrin, objektin e aktivitetit, kapitalin fillestar dhe ndarjen e tij, etj.</p> <p>Prova e adresës së shoqërisë (kontrata e qirasë ose dokumente të tjera të ngjashme).</p> <p>Deklarata për kapitalin fillestar të shoqërisë (kapitali minimal për një Sh.P.K. është 100,000 lekë).</p> <p>3. Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR)</p> <p>Regjistrimi mund të bëhet online përmes portalit të QKR-së, ose mund të dorëzoni dokumentet në një nga degët e QKR-së.</p> <p>Pagesa e tarifës së regjistrimit: Tarifa e regjistrimit për një Sh.P.K., përbën pjesa e nënshkrimit elektronik.</p> <p>Pasi të dorëzoni dokumentat, QKR verifikon informacionin dhe, nëse gjithçka është në rregull, regjistron shoqërinë dhe lëshon certifikatën e regjistrimit.</p> <p>4. Regjistrimi në Administratën Tatimore</p> <p>Pas regjistrimit në QKR, duhet të regjistroheni gjithashtu pranë Administratës Tatimore për qëllime tatimore (NIPT - Numri i Identifikimit të Personit Tregtar). Ky regjistrim mund të bëhet automatikisht pas regjistrimit në QKR, por është e nevojshme të kontrolloni</p>		
--	--	--	--	--	--

				dhe të konfirmoni që procesi është realizuar.		
35	19.12.2024	Kërkesë për vërtetim për pagën e përfituar në IKTK dhe tatimin e paguar në burim.	23.12.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, lutemi mund të paraqiteni pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore ku keni juridiksionin tuaj, për të tërhequr vërtetimin.	E plotë	Nuk ka
36	20.12.2024	Informacion për procedurat që nevojiten për të aplikuar për statusin pasiv të një OJF-je? A kryhet përmes e-albania?	23.12.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Kalimi në status pasiv i OJF-ve bëhet me kërkesë të subjektit ose nga Administrata Tatimore kur përmbushen kushtet ligjore. Me kërkesë të subjektit- kur ky i fundit vendos të ndërpresë aktivitetin për një periudhë më shumë se 12 muaj ose pa afat Nga Administrata Tatimore në rast se subjekti dorëzon deklaratë pa aktivitet (me zero) ose kur nuk deklaron për një periudhë më shumë se 12 muaj të njëpasnjëshëm. Për të gjithë periudhën që subjekti ndodhet në status “Pasiv”, ai nuk ka detyrimin për të dorëzuar deklaratat tatimore (gjenerimi i deklaratave ndërpritet automatikisht).	E plotë	Nuk ka

				Mund të aplikoni edhe në shërbimin <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13939">e-Albania, https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13939</a> .		
--	--	--	--	---	--	--

Shënim: (1) Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

(2) Data e regjistrimit të kërkesës.

(3) Përmbledhje e objektit të kërkesës duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

(4) Data e kthimit të përgjigjes.

(5) Përmbajtja e përgjigjes duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

(6) Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar

(7) Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit ) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik